

Neni 1 Objekti

Objekti i kesaj rregulloreje eshte percaktimi i procedurave dhe dokumentacionit per identifikimin e klientit, rregullave per regjistrimin, ruajtjen e te dhenave dhe raportimin e tyre tek autoriteti pergjegjes nga subjektet e kesaj rregulloreje.

Neni 2 Qellimi

Kjo rregullore ka per qellim parandalimin e perdorimit te "Posta Shqiptare" per pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit. Ajo krijon kushte dhe u sherben Filialeve/Degeve dhe Drejtorive perkatese per identifikimin e klienteve perpara kryerjes se veprimit financiar, regjistrimit dhe raportimit te transaksioneve tek "Autoriteti pergjegjes" me qellim parandalimin e pastrimit te parave dhe parandalimin financimin e terrorizmit.

Neni 3 Subjektet

Subjekte te kesaj rregulloreje jane Drejtoria e Sherbimeve Bankare e Financiare, Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Sigurimit te Standarteve te Cilesise dhe Sigurimit Postar si dhe te gjitha Filialet dhe Deget e "Posta Shqiptare" SH.A.

Neni 4 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet ne mbeshtetje e per zbatim te nenit 12 germa "a" dhe 43 germa "c" te ligjit nr.8269, date 23.12.1997 "Per Banken e Shqiperise"; te nenit 9 te ligjit nr.9662, date 18.12.2006 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise"; te nenit 27 te ligjit nr.9258, date 15.07.2004 "Per masat kunder financimit te terrorizmit", te neneve 7,11.24 dhe 26 pika 2, te ligjit Nr. 9917, date 19.05.2008 "Per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit", ndryshuar me ligjin nr.10391, date 03.03.2011.

Neni 5 Perkufizime dhe referenca

Termet e perdorura ne kete rregullore kane te njejtin me kuptim me termat e perdorur ne ligjin nr.9917, date 19.05.2008 "Per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit", ndryshuar me ligjin nr.10391, date 03.03.2011³ si dhe ne ligjin Nr.9662, date 18.12.2006 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise". Per qellimet e kesaj rregulloreje, termat e meposhtem kane keto kuptime:

1. **"Pastrim i Parave"** eshte qarkullimi/riqarkullimi i parave qe rrjedhin nga veprat penale si dhe transferimi, transformimi ose tjetersimi i produkteve dhe i pasurive te rrjedhur nga veprat penale, me qellim fshehjen e burimit ose te origjines se tyre te paligjshme.
2. **"Autoriteti Pergjegjes"** eshte Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave ne Ministrine e Financave.
3. **"Kliente"** jane te gjitha individet apo personat fizike/juridike qe kryejne ose kerkojne te kryejne veprime financiare me "Posta Shqiptare" SH.A.

4. **“Personat e ekspozuar politikisht”** jane personat , të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarimin e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjisllacionit për shërbimin civil. Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike
5. **“Pronar perfitues”** eshte personi fizik ose juridik, qe zoteron ose kontrollon i fundit nje klient dhe/ose personi, per llogari te te cilit kryhet nje transaksion.
6. **“Transaksion”** eshte nje marrdhenie biznesi apo nje shkembim qe perfshin dy ose me shume pale.
7. **“Transaksione te lidhura me njeri-tjetrin”** jane dy ose me shume transaksione (duke perfshire transfertat e drejtperdrejta”, ku sejcila prej tyre eshte me i vogel sesa shume e percaktuar si prag, ne baze te nenit 6 te kesaj rregulloreje dhe kur keto transaksione ne shume totale barazojne ose tejkalojne shumen e pragut te zbatueshem.
8. **“Vigjence e zgjeruar ndaj klientit”** eshte nje proces me i thelle kontrolli, pertej procedurave “njihe klientin tend”, qe synon te krijojte sigurine e mjaftueshme per te verifikuar dhe vleresuar identitetin e klientit; per te kuptuar dhe testuar profilin e klientit, per te identifikuar informacionet me rendesi dhe per te vleresuar rrezikun e mundshem per pastrim parash/financim terrorizmi, ne mbeshtetje te vendimeve qe synojne mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale si dhe pershtatjen ndaj kerkesave ligjore.
9. **“Person”**, ne kuptim te ligjit dhe kesaj rregulloreje, konsiderohen individet, personat fizike tragtare dhe personat juridike.
10. **“Raporti i aktivitetit te dyshimte” (RAD)** eshte formulari qe i bashkelidhet kesaj rregulloreje me ane te te cilit raportohet tek Autoriteti Pergjegjes per cdo transaksion apo aktivitet te dyshimte.
11. **“Raporti i transaksionit te parase fizike” (RTPF)**, eshte formulari qe i bashkelidhet kesaj rregulloreje me ane te te cilit subjektet raportojne tek Autoriteti Pergjegjes cdo transaksion ne para fizike ne nje vlere te barabarte ose me te madhe se 1 500 000 (nje milione e peseqinde mije)leke ose kundervlera ne monedha te tjera te huaja, te kryer si nje transaksion i vetem ose si transaksione te lidhura me njeri-tjetrin.
12. **“Raporti i vet kontrollit”** eshte formulari qe i bashkelidhet kesaj rregulloreje dhe qe plotesohet dhe raportohet nga subjektet me kerkesen e “Autoritetit Pergjegjes”, ne lidhje me permbushjen prej tyre te detyrimeve ligjore.

Neni 6 Identifikimi i klientit

Identifikimi i plote dhe i sakte i klientit eshte pergjegjesi dhe detyrim i "Posta Shqiptare" SH.A. Eshte e rendesishme qe "Posta Shqiptare" te njohe klientet e saj ne menyre qe te arrihet parandalimi i pastrimit te parave dhe/ose financimi i terrorizmit.

1. Posta Shqiptare, duhet të identifikojë klientët dhe të verifikojë identitetin e tyre me anë të dokumenteve të identifikimit:

- a) para se të vendosin një marrëdhënie biznesi;
- b) kur klienti, në raste të ndryshe nga ato të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike, kryen ose kërkon të kryejë:
 - një transfertë të drejtpërdrejtë brenda ose jashtë vendit në një **shumë të barabartë ose më të madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja;**
 - një **transaksion me një shumë të barabartë me:**
 - i) **jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja** për subjektet e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “g” të nenit 3 të këtij ligji;
 - ii) **jo më pak se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryer në një transaksion të vetëm, ose në disa transaksione të lidhura me njëri-tjetrin.** Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi duhet të kryhet sapo të bëhet e ditur shuma dhe të arrihet pragu i mësipërm;
- c) kur ka dyshime për vërtetësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë;
- ç) në të gjitha rastet kur ka të dhëna ose dyshime të mjaftueshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

2. Posta Shqiptare **duhet të identifikojë dhe të verifikojë identitetin e pronarit përfitues.** Ne rastet kur klienti është person juridik duhet kryer identifikimi dhe verifikimi për zoteruesit përfundimtar të personit juridik duke kërkuar dokumente shtese të cilat provojnë identitetin dhe lidhjen e pronarit përfitues apo zoteruesit përfundimtar me personin juridik dhe me atë që kryen transaksionin.
3. Ne rastet kur klienti apo pronari përfitues është një kompani aksionere e listuar në bursë të njohur financiare jashtë vendit dhe është subjekt i detyrimeve për raportim në një autoritet rregullator nuk është e nevojshme të identifikohet dhe verifikohet identiteti i aksionereve të kompanisë. Për qëllime të kësaj rregulloreje bursë e njohur financiare do të konsiderohen bursat e vendeve anetare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.
4. Cdo informacion shtese që mund t'i duhet Autoritetit Përgjegjës, sigurohet vetëm nëpërmjet personit përgjegjës të autorizuar.

Neni 7

Procedurat dhe dokumentacioni për identifikimin e klientit

Ne zbatim të ligjit dhe të kësaj rregulloreje, të gjitha zyrat postare janë të detyruara të ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.

1. Identifikimi i klienteve (të përhershëm apo rastësor) dhe verifikimi i identitetit të tyre me anë të dokumenteve të vlefshme origjinale ose fotokopje të noterizuara:
 - a. Për individët dhe përfaqësuesit ligjorë:
 - i. Letenjoftim ID (Karte Identiteti);
 - ii. Pasaportë;
 - b. Për individë jorezidentë:

- i. Pasaporte, brenda afatit te skadences;
 - ii. ID Karte Identiteti (vetem per vendet e BE-se), brenda afatit te skadences;
 - c. Per personat fizike dhe juridike qe zhvillojne veprimtari fitimpruese:
 - i. Statuti;
 - ii. Akti i themelimit;
 - iii. Ekstrakt te leshuar nga QKR;
 - iv. NUIS/NIPT
 - d. Per shoqeri jo-rezidente:
 - i. Dokumentacioni qe verteton regjistrimin e shoqerise se huaj ne vendin e rezidences (Vendim i gjykates ose ekstrakt nga regjistri tregtar);
 - ii. Statuti i shoqerise;
 - iii. Dokumenti i identifikimit te personave te autorizuar;
 - e. Per personat juridike qe nuk zhvillojne veprimtari fitimpruese:
 - i. Akti i themelimit te shoqerise;
 - ii. Statuti i shoqerise;
 - iii. Vendimin e gjykates per regjistrimin si person juridik.
- 2. Ne rastet kur ekziston nje dyshim i arsyeshem, punonjesit e sherbimit mund te kerkojne informacion shtese per nje identifikim te sakte te klientit. Dokumente te tjera qe mund te kerkohen nga punonjesi i sherbimit, por pa u kufizuar vetem ne to, sipas nevojës per identifikimin dhe per verifikimin e identitetit te klientit, si dhe ne te gjitha rastet kur ka te dhena ose dyshime per pastrim parash ose financim te terrorizmit jane:
 - a. Per individet dhe perfaqesuesit ligjore:
 - i. Certifikata te leshuara nga Zyra e Gjendjes Civile;
 - ii. Diploma shkollore/universitare;
 - iii. Leje drejtimi e automjetit;
 - iv. Leje hyrje apo qendrimi per te huajt;
 - v. Libreza apo kontrate pune;
 - vi. Kontrata e blerjes/qirase se baneses;
 - vii. Kontrata me operatore sherbimesh, si telefon fiks, mobile, uje, energji elektrike, etj;
 - viii. Vertetim vendbanimi te leshuar nga autoritetet vendore;
 - b. Per personat fizik dhe juridike qe zhvillojne veprimtari fitimpruese:
 - i. Certifikate Rregjistrimi te personit te tatueshem;
 - ii. Leje/licensat e ushtrimit te aktivitetit;
 - iii. Kontrata e blerjes/qirase se selise dhe vendit te ushtrimit te aktivitetit;
 - c. Per personat juridike qe nuk zhvillojne veprimtari fitimpruese:
 - i. Certifikate Rregjistrimi te Personit te Tatueshem;
 - ii. Leje/licensat e ushtrimit te aktivitetit;
 - iii. Kontrata e blerjes/qirase se selise dhe vendit te ushtrimit te aktivitetit;
- 3. Identifikimi i klienteve behet gjithnje nga Posta Shqiptare dhe mbeshtetja tek palet e tjera per kryerjen e ketij procesi nuk eshte e pranueshme.

4. Posta Shqiptare/punonjesi i shërbimit pranon nga klienti për të marrë të dhëna për të, sipas përcaktimeve të këtij neni, **vetëm dokumente origjinale ose fotokopje të noterizuara**. Për qëllime të kësaj rregulloreje, Posta Shqiptare mban në dosjen e klientit kopje të vulosura me vulën e subjektit, të dokumenteve të paraqitura nga klienti në formën e mësipërme, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.
5. Punonjesi i shërbimit të "Posta Shqiptare" **nuk kryen veprime financiare** nëse klienti nuk deklaron burimin e shumës së parave të transaksionit dhe identitetin e përfituesit. Deklarimi i burimit të shumës do të bëhet sipas formularit bashkangjitur dhe pjesë e kësaj rregulloreje.
6. Punonjesi i shërbimit të "Posta Shqiptare" SH.A. **refuzon të hyjë në marrëdhënie biznesi në** rast se nga ana e klientit nuk plotësohen kërkesat për identifikimin e tij.
7. Në rast se edhe pas ndonjë veprimi, punonjësit e shërbimit të "Posta Shqiptare" SH.A. dyshojnë për identitetin fiktiv të klientit, ata pezullojnë menjëherë çdo veprim me klientin dhe njoftojnë personin përgjegjës në Drejtorinë e Përgjithshme mbi këto dyshime. Personi përgjegjës në Drejtorinë e Përgjithshme lajmëron autoritetin përgjegjës sipas kërkesave për raportim të përcaktuara në këto rregullore.
8. Dokumentacioni i plotë identifikues shpërndahet në etapën e lëvizjes së saj nga dërguesi i parë deri tek përfituesi i fundit.
9. Punonjësit e shërbimit të "Posta Shqiptare" SH.A. u ndalohej të japin informacione në lidhje me procedurat e verifikimit të rasteve të dyshimta, si dhe për çdo raportim tek autoriteti përgjegjës.
10. Çdo riprodhim (kopje) e dokumentave identifikues të klientit që mbahen në "Posta Shqiptare", duhet të mbaje nënshkrimin e punonjësit të shërbimit në sportel që ka pranuar këtë dokumentacion.

Neni 8 Vigjelenca e duhur

Ne kuadrin e zbatimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, Posta Shqiptare:

1. Merr masa për të kuptuar strukturën e pronësive dhe të kontrollit të klientëve, që janë persona juridikë dhe për të përcaktuar se cilët janë individët që kanë në pronësi apo kontrollojnë klientin. Këtu përfshihen ata individë që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik.
2. Që para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënie përcakton për të gjithë klientet nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe merr masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi.
3. Siguron informacion për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënieve të biznesit.

Posta Shqiptare zbaton keto masa per vigjilencen e duhur edhe ndaj klienteve ekzistues, bazuar ne te dhena, fakte dhe nivelin e riskut te ekspozimit te tyre ndaj pastrimit te produkteve te veprave penale apo financimit te terrorizmit.

Neni 9

Vigjelenca e zgjeruar ndaj klientit

1. Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, punonjesi i shërbimit duhet të kërkojë praninë fizike të klientëve dhe përfaqësuesve të tyre:
 - a) para se të vendosin një marrëdhënie biznesi;
 - b) para së të kryejnë transaksione në emër dhe për llogari të tyre.
2. Posta Shqiptare dhe punonjesi i shërbimit duhet t'ju kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor dhe njëkohësisht të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla. Te dhenat mbi konkluzionet e analizave duhet të mbahen për një periudhë pesë vjeçare dhe t'ju vihen në dispozicion Autoritetit Përgjegjës.
3. Posta Shqiptare përfshin në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e menaxhimit të riskut për të përcaktuar ndër të tjera, nëse një klient apo personat e lidhur me të janë Persona të Ekspozuar Politikisht. Në këtë kontekst:
 - a. Merret informacion në burimet e disponueshme të tilla si: lista e perditesuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (Worldcheck, Factiva, etj) si dhe burimet e hapura të informacionit për personat e huaj;
 - b. Merret miratimi i drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit apo vazhdimin e këtyre marrëdhënieve kur një klient ekzistues behet person i Ekspozuar Politikisht;
 - c. Kryhet një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta kliente;
4. Punonjesi i shërbimit përcakton nëse klientet janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe duhet të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi..

Neni 10

Masat parandaluese

Në përputhje me ligjin dhe këto rregullore, Posta Shqiptare ka detyrimet e mëposhtme:

- a) të emërojë një person përgjegjës dhe një zëvendëspërgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, tek të cilat të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi
- c) të krijojë një sistem të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave;
- ç) të zbatojë procedurat përzgjedhëse për punonjës të rinj, për t'u siguruar për integritetin e tyre;

- d) të trajnojë punonjësit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit përmes organizimit periodik të programeve të kualifikimit;
- dh) të ngarkojë kontrollin e brendshëm për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet e këtij ligji dhe të akteve përkatëse nënligjore;
- e) të sigurojë se filialet dhe degët veprojnë në përputhje me këtë ligj.
- ë) të paraqesë informacion, të dhëna dhe dokumente shtesë, autoritetit përgjegjës, në përputhje me kërkesat dhe afatet kohore për rastet e parashikuara në ligj.

Postes Shqiptare i ndalohet të hapë ose të mbajë marrëdhënie biznesi me klientë anonimë apo që përdorin emra fiktivë.

Neni 11

Procedura e regjistrimit dhe ruajtjes së të dhënave

"Posta Shqiptare" krijon dhe mban një bazë të dhënash (database) për klientelën, të përbërë nga karakteristikat ekonomike dhe financiare të tyre. Kjo bazë të dhënash i shërben punonjësit të shërbimit për të vlerësuar dhe identifikuar transaksionet kombëtare dhe ndërkombëtare, potencialisht të lidhura me veprimtari të paligjshme. Në këtë bazë të dhënash (database) regjistrohet çdo informacion që ka lidhje me identifikimin e klientit dhe për çdo transaksion financiar të kryer në emër dhe për llogari të tij. Ruajtja e këtij informacioni bëhet në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave".

I - Regjistrimi i të dhënave

Regjistrimi i të dhënave bëhet sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Përgjegjës:

1. "Posta Shqiptare" bën regjistrimin e të dhënave të përcaktuara për çdo transaksion dhe klient që kryen veprime financiare në emër të tij ose për llogari të të tjerëve në sportelet e saj, në ose mbi shumën 1.500.000 (një milionë e pesëqind mijë) leke ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja.
2. Filialet dhe Degët regjistrojnë të gjitha veprimet financiare të çdo klienti për shumën e parashikuar në nenin 6, ndërsa Drejtoria e Shërbimeve Bankare dhe Financiare mbledh të gjitha raportimet e bera nga Filialet/Degët dhe mban të dhënat për të gjithë rrjetin e saj. **Keto regjistrime bëhen nga personi përgjegjës "Posta Shqiptare" në Drejtorinë e Shërbimeve Bankare dhe Financiare në regjistrin brendshëm "Për identifikimin e klientëve mbi 1.5 milionë leke".**
3. "Posta Shqiptare" ka të drejtë që për çdo transaksion të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime në mënyrë që të dalë qartë burimi i krijimit të parave që përdoren për transaksion dhe përfituesin e këtij transaksioni si dhe të evidentojë këto burime.
4. Pas regjistrimit, nëse ka elemente të dyshimta, raportohet tek Autoriteti Përgjegjës për çdo veprim financiar edhe nën vlerën e përcaktuar më lart,

ne rastet kur ka te dhena, bazuar ne fakte apo rrethana konkrete apo dyshime per pastrim parash ose financim te terrorizmit. Informacioni i grumbulluar duhet t'u krijoje mundesine autoriteteve te ringrene ciklin e plote te transaksionit. Ky informacion duhet te sigurohet nga "Posta Shqiptare" SH.A. nepermjet identifikimit te klientit.

5. Te gjitha te dhenat per klientin dhe transaksionet si dhe informacioni i kerkuar per t'u mbajtur, do te vihen menjehere ne dispozicion me kerkesen e Autoritetit Pergjegjes si nga Filialet dhe Deget, ashtu edhe nga Drejtoria e Sherbimeve Bankare e Financiare ku ruhet ky informacion

II - Ruajtja e te dhenave

1. "Posta Shqiptare" **ruan dokumentacionin** e paraqitur per identifikimin e klientit dhe perfituesit te transaksionit qe nga kryerja e veprimit (transaksionit) te pare financiar, perfshire edhe ndryshimet e tij gjate kohes, per nje periudhe prej jo me pak se 5 vjet nga dita e nderprerjes se marredhenieve te klientit.
2. "Posta Shqiptare" **ruan regjistrimet e te dhenave** dhe dokumentacionin per cdo transaksion, perfshire edhe te dhenat per klientin, pavaresisht faktit nese transaksioni kryhet per llogari te tij apo per llogari te te treteve, se bashku me te gjitha dokumentacionin justifikues, per nje periudhe prej jo me pak se 5 vjet nga data e kryerjes se veprimit financiar.
3. Informacioni elektronik dhe dokumentacioni i transaksioneve do te ruhen per nje afat prej jo me pak se 5 vjet nga data e regjistrimit fillestar te tyre.
4. Dokumentat fizike te klientit lidhur me transaksionet mbahen dhe ruhen prane Filialeve/Degeve te "Posta Shqiptare" SH.A.
5. Perjashtimisht nga sa percaktohet ne pikat II/1, II.2 dhe II.3 te ketij neni, me kerkese te Autoritetit Pergjegjes, dokumentacioni dhe informacioni mbi transaksionet (fizik dhe elektronik) ruhen per me shume se 5 vjet, edhe nese llogaria ose marredhenia e biznesit ka perfunduar.

Neni 12

Strukturat pergjegjese

1. "Posta Shqiptare" SH.A., ne zbatim te nenit 11 te kesaj rregulloreje, cakton strukturat dhe personat pergjegjes ne realizimin e detyres se saj per te luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Keta persona duhet te kene autoritetin e mjaftueshem dhe pervojen e nevojshme per te kryer kete detyre. Drejtoria e Sherbimeve Bankare e Financiare eshte struktura pergjegjese e "Posta Shqiptare" SH.A. ne parandalimin e perdorimit te ketij institucioni per pastrimin e parave dhe/apo financimin e terrorizmit.
2. Drejtori i Drejtorise se Sherbimeve Bankare e Financiare eshte **personi pergjegjes** per parandalimin e pastrimit te parave dhe/apo financimin e terrorizmit. Ai dhe Specialisti i Sherbimeve Bankare (personi zevendespergjegjes) kane pergjegjesine per te permbushur detyrimet e "Posta Shqiptare" SH.A. lidhur me parandalimin e pastrimit te parave dhe/apo financimin e terrorizmit si dhe per te raportuar prane Autoritetit Pergjegjes. Ata mbajne kontakte te vazhdueshme me Autoritetin Pergjegjes dhe Banken e Shqiperise per te permbushur sa me mire rolin e

tyre ne kete detyre.

3. Personat përgjegjës kanë akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave, të parashikuara në nenin 16 të ligjit.
4. "Posta Shqiptare" njofton Banken e Shqiperise dhe Drejtorine e Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave per emrin e personit pergjegjes si dhe ne te gjitha rastet kur ka ndryshime te ketij personi.
5. Drejtoria e Sherbimeve Bankare e Financiare harton dhe dergon per miratim ne Drejtorine e Shoqerise Rregulloren e brendshme per parandalimin e pastrimit te parave dhe ose financimin e terrorizmit si dhe propozime per ndryshime. Nje kopje e miratuar e kesaj rregulloreje i dergohet menjehere Bankes se Shqiperise.
6. Personi pergjegjes per parandalimin e pastrimit te parave dhe/apo financimin e terrorizmit:
 - Harton programin vjetor te trajnimit te personelit te sporteleve dhe cdo personi/stafi te "Posta Shqiptare" qe ne ushtrimin e detyrave te tij ne kompani mund te ekspozohet ndaj riskut te pastrimit te parave. Ne kete program duhet te perfshihen procedurat e brendshme te "Posta Shqiptare" qe rregullojne veprimtarine e parandalimit te pastrimit te parave dhe/ose financimit te terrorizmit si dhe ndryshimet ne keto procedura, shembuj konkrete te rasteve te dyshimta. Kopje te ketyre dokumentave i dergohen Bankes se Shqiperise menjehere pas miratimit te tyre.
 - Informon periodikisht stafin e "Posta Shqiptare" SH.A. per ndryshimet e kuadrit rregullator brenda dhe jashte institucionit lidhur me veprimtarine e parandalimit te pastrimit te parave dhe/ose financimit te terrorizmit.
 - Monitoron mirembajtjen e bazes se te dhenave per klientet dhe transaksionet e tyre ne ato veprimtari ku kompania eshte me e ekspozuar ndaj veprimtarise se mundshme kriminale te pastrimit te parave qe rrjedhin nga aktivite te paligjshme.
 - Merr masa per zbatimin e konceptit te vigjelences se duhur dhe te zgjeruar, bazuar ne nenin 8 dhe 9 te kesaj rregulloreje dhe percakton kategori te tjera klientesh dhe transaksionesh ndaj te cilave zbatohen masat e vigjelences se zgjeruar dhe i pasuron keto kategori me kalimin e kohes.

Neni 13

Raportimi i aktiviteve te dyshimta tek Autoriteti Pergjegjes

1. Personi pergjegjes i "Posta Shqiptare" per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit i paraqet raport autoritetit përgjegjës, ku parashtron dyshimet që ka për rastet kur e di apo dyshon se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit. Raportimi bëhet me ane te formularit RAD menjehere dhe jo me vone se 72 ore. Nje kopje e ketij njoftimi dergohet edhe ne Banken e Shqiperise (Departamentit te Mbikqyrjes).

2. Raportimi kryhet pas shqyrtimit të plotë të elementeve të dyshimta dhe të dhenave që Posta ka në dispozicion për të arsyetuar ato, pavarësisht shumës së transaksioneve të kryera/ose që janë duke u kryer/ose që do të kryhen.
3. Formulari RAD duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, që mbështet dyshimet e parashtruara në raport, si: dokumentat e identifikimit, të dhenat transferive, etj. Dërgohet i plotë me shkresë zyrtare.
4. Në raste urgjente, informacioni mund të percillet tek Autoriteti përgjegjës, shoqëruar me shkresë zyrtare, sipas afatit të pikës 1 të këtij neni.
5. Kur transaksioni që kërkohet të kryhet nga klienti, ka dyshime se (transaksioni) mund të përfshijë pastrim parash ose financim terrorizmi, ai duhet t'ia raportojë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin duke marrë përgjigje brenda 48 orëve.
6. Punonjësi i shërbimit në sportel të "Posta Shqiptare" SH.A., për çdo transaksion të cili për nga karakteristikat, natyra e tij, etj, ka arsye të besojë ose dyshojë se mund të jetë i përfshirë në pastrim parash, financime të dyshimta ose financim të terrorizmit, zbaton procedurat e percaktuara duke vënë në dijeni personin përgjegjës në Filial (Kryetarin e Degës së Shërbimeve) dhe kërkon prej tij udhëzimet përkatëse për veprim të mëtejshëm (kryerjen ose jo të transaksionit).
7. Lidhur me transaksionet e dyshimta, personat përgjegjës në drejtoritë e Filialeve/Degëve, shqyrtojnë njoftimet e punonjësve që kanë identifikuar një transaksion të dyshimta dhe vendosin për të njoftuar ose jo personin përgjegjës në Drejtorinë e Shërbimit Bankar, jo më vonë se 8 orë pas identifikimit të transaksionit.

Neni 14

Raportimi i transaksioneve të vlerave tek Autoriteti Përgjegjës

Personi përgjegjës i "Posta Shqiptare" për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i raporton autoritetit përgjegjës, brenda pesë ditëve pune, të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

Neni 15

Mbikqyrja

Kjo rregullore dhe zbatimi i saj është objekt i mbikqyrjes nga Banka e Shqipërisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Banka e Shqipërisë mbikqyr zbatimin e dispozitave të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave" dhe akteve nenligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 16
Kerkesa per ruajtjen e konfidencialitetit

Punonjesit e sherbimit te "Posta Shqiptare" detyrohen te ruajne konfidencialitetin e procesit te verifikimit dhe raportimit iidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Atyre **u ndalohet** te njoftojne/informojne klientet ose cdo person tjetër ne lidhje me procedurat e verifikimit te rasteve te dyshimta si dhe per raportimet e bera tek Autoriteti Pergjegjes.

Neni 17

"Posta Shqiptare" SH.A. i kushton **vemendje** rasteve kur Filiale/Dege te vecanta kerkojne furnizim jot e zakonshem ne vlera monetare si dhe rasteve qe perfaqesojne transaksione ne cash per vlera qe i kalojne shume kerkesat e zakonshme, ne baze te karakteristikave te zones dhe te klienteles qe i sherbehet.

Neni 18
Strukturat zbatuese

Drejtoria e Sherbimeve Bankare e Financiare dhe Drejtoria e Sigurimit te Standarteve te Cilesise dhe Sigurimit Postar ne "Posta Shqiptare" SH.A. ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e kesaj rregulloreje, te kerkesave te ligjit "Per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit" si dhe akteve nenligjore perkatese.

Neni 19
Shfuqizime

Rregullorja nr.prot.1852,date 26.07.2010 "Per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimit te terrorizmit", shfuqizohet.

Neni 20
Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore se bashku me anekset I, II, III, IV bashkelidhur, te cilat jane pjese perberese e saj, hyjne ne fuqi menjehere.

ARQILE GOREA

DREJTOR I PERGJITHSHEM